

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme Kosovës – koleji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Nebojsha Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit A. M., nga Drenasi, për shkak të veprës penale cenim i të drejtave të punësimit në vazhdimësi nga neni 183 par. 1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit A. M., avokat E. K., nga Prishtina, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR.nr. 519/2014 datë 30.11.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr. 156/2016 datë 08.04.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 29 gusht 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A. M., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR.nr. 519/2014 datë 30.11.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr. 156/2016 datë 08.04.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR.nr. 519/2014 datë 30.11.2015, i dënuari A. M. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale cenim i të

drejtave të punësimit në vazhdimësi nga neni 183 par. 1 të KPK dhe për këtë vepër është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 2.000 €, të cilën dënim është i detyruar që ta paguajë brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mos pagesës dënimi do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke i llogaritur një ditë burgim me 20 € të gjobës. I është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Është detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit A. M., Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin e saj PAKR.nr. 156/2016 datë 08.04.2016, ka refuzuar ankesën, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A. M., avokat E. K., nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr. 125/2016 datë 12.07.2016, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e neni 435 par. 1 dhe neni 436 par. 1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika

1.10 të KPPK, sepse është tejkaluar akuza e cila shkelje konsiston në atë se gjykata e shkallës së parë, të dënuarit përveç dënimit kryesor me gjobë i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve publike në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Në kërkesë më tej theksohet se në rastin konkret gjykata nuk ka mundur t'i shqiptoj këtë dënim meqë nuk ka pasur propozimin e Prokurorit të Shtetit dhe kështu është shkelur dispozita e nenit 65 par. 2 të KPK.

Shkelje tjetër sipas pretendimeve në kërkesë është dispozita e nenit 384 par. 1 pika 1.12 të KPPK, sepse aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par. 7 dhe 8 të KPPK, sepse gjykatat nuk kanë dhënë arsye se cilat prova i ka konsideruar të vërtetuara apo të pavërtetuara, sepse dispozitivi i aktgjykimit ishte i paqartë dhe në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin lidhur me kohën e kryerjes së veprës penale sepse në dispozitiv ceket se vepra është kryer brenda afatit kohor të vitit 2009.2012, ndërsa veprimi i fundit nga i akuzuari është ndërmarrë më 22.02.2012. Po ashtu, thekson se nuk janë dhënë arsye për faktet relevante, mirëpo nuk precizon se ku qëndrojnë këto shkelje.

Duke pasur parasysh se gjykata e shkallës së dytë nuk ka evituar shkeljet e përmendura e nga ana tjetër nuk ka dhënë arsye lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë edhe ky aktgjykim është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Pjesa tjetër e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë i referohet shkeljes së ligjit penal e cila shkelje konsiston në atë se të dy gjykatat lidhur me caktimin e dënimit vetëm kanë konstatuar rrethanat e vlerësuara ndërsa nuk kanë dhënë arsye se cilat ishin ato vendimtare dhe në çfarë mënyre kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit, ndërsa fare nuk kanë vlerësuar kontributin e të dënuarit si menaxher sepse ai është shpallur drejtor më i suksesshëm nga drejtoritë komunale në nivel të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë për këto arsye:

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, i dënuari A. M. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale cenimi i të drejtave në punësim në vazhdim nga neni 183 par. 1 të KPK, sepse në periudhën kritike që nga viti 2009 e gjer në vitin 2012 të dëmtuarit H. S. ia ka mohuar të drejtën për të konkurruar për punësim ashtu që pa hapur fare konkurs ka pranuar në punë A. H.1, L. L., R. C. dhe A. H.2 e sipas një konkursi të përgjithshëm të shpallur kohë më parë, në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 210/03-4-L-2012 dhe dispozitat ligjore nga neni 2 par. 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27.

Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka tejkallim të akuzës dhe nuk është shkelur dispozita e nenit 384 par. 1 pika 1.10 të KPPK, për faktin e kjo dispozitë në mënyre taksative ka precizuar se kur kemi të bëjmë me tejkallim të akuzës e që në rastin konkret nuk qëndron, ndërsa nga ana tjetër siç rezulton nga shkresat e çështjes, identiteti objektiv dhe subjektiv në mes të aktgjykimit dhe aktakuzës (neni 360 të KPPK), në asnjë mënyrë nuk është cenuar.

Aktgjykimet e kundërshtuara – aktgjykimi i shkallës së parë, pra dispozitivi i tij është i qartë dhe konkret, nuk ka kundërthënie me vetveten dhe me arsyetimin e aktgjykimit. Dispozitivi përmban të gjitha elementet e parapara ligjore ku në mënyrë precize janë specifikuar të gjitha veprimet konkrete të ndërmarra nga i dënuari madje edhe lidhur me kohën e kryerjes së veprës e cila është precizuar në dispozitiv si periudha kohore nga viti 2009 deri në vitin 2012, konstatim ky i cili në asnjë mënyrë nuk paraqet kundërthënie dhe paqartësi në kuptimin e pretendimeve nga kërkesa meqë është evidente se këtu është përfshirë edhe viti 2012, intervali kohor kur janë ndërmarrë veprimet inkriminuese, pra brenda së cilit është ndërmarr edhe veprimi i fundit më datën 21.02.2012.

Nuk qëndron pretendimi se të dy gjykatat në vendimet e tyre nuk kanë dhënë arsye për faktet vendimtare, për faktin se siç rezulton nga shkresat e çështjes të dy gjykatat në veçanti ajo e shkallës së parë në mënyrë gjithëpërfshirëse ka vlerësuar të gjitha provat e administruara, duke dhënë arsye për të gjitha pikat e aktakuzës sikurse edhe për dashjen e të dënuarit si element subjektiv i veprës penale si dhe për dënimin. Vlerësimi i provave, në

veçanti atyre kontradiktore është bërë në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 370 par. 7 të KPPK, për çfarë ka dhënë arsye të plota të cilat i ka konfirmuar edhe gjykata e shkallës së dytë, e cila në aktgjykimin e saj në faqen 2 dhe 3 të aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftuara, lidhur me të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo Gjykatë.

Për sa i përket shkeljes së ligjit penal se është shkelur dispozita e nenit 65 par. 2 të KPK, për faktin se gjykatat nuk kanë mundur të shqiptojë dënimin plotësues meqë ky dënim nuk është propozuar nga Prokurori i Shtetit, kjo Gjykatë e vlerëson si të pabazuar.

Sipas dispozitës së nenit 65 par. 1 të KPK, është paraparë që gjykata ia ndalon kryerësit ushtrimin e funksioneve në Administratën Publike ose në shërbimin publik prej 1 deri në 5 vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi i tillë ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim, normë kjo që është imperative kurse, sipas paragrafit 2 të njëjtës dispozitë, në të cilën është thirrur mbrojtësi i të dënuarit në kërkesën e ushtruar, është paraparë që gjykata mund t'ia ndaloj kryerësit ushtrimin e funksioneve në Administratën Publike ose në shërbimin publik prej 1 deri në 3 vjet, nëse personi i tillë i ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me gjobë ose me dënim me kusht.

Në rastin konkret drejtë ka vepruar gjykata kur të dënuarit i ka shqiptuar dënimin plotësues sepse në rastin konkret janë plotësuar kushtet e parapara ligjore. Sipas dispozitës së lartë cekur shqiptimi i këtij dënimi është fakultativ dhe është e drejtë diskrecionale e gjykatës që edhe pa propozimin e prokurorit të shtetit, të shqiptoj këtë dënim plotësues por, pas vlerësimit të gjykatës për arsyeshmërinë e tij, prandaj pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë qartazi dalin si të pa bazuara.

Vlen të theksohet se cilësimi juridik i veprës penale është rezultat i vlerësimit të drejtë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor, prandaj konkludimet e të dy gjykatave lidhur me fajësinë e të dënuarit për çfarë janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike, si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo Gjykatë, pra drejt është aplikuar ligji penal.

Nga arsyet e lartcekura kjo Gjykatë refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.171/2016, më 29.08.2016

Procesmbajtësja,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Avdi Dinaj